



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 450 Prot.

Tiranë, më 02.07 2015

**VENDIM Nr. 69 datë 23.06.2015**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore” (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.9, të datës 23.06.2015, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Alinura"* miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Prof. Dhimitër Çondi (IA) dhe Dr. Jose C. Carvajal Lopez (University College of London, Qatar),


**VENDOSI:**

- I. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Alinura"* paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Prof. Dhimitër Çondi (IA) dhe Dr. Jose C. Carvajal Lopez (University College of London, Qatar), në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
  - Sërvej në zonën përreth gjirit të Alinurës.
  - Gërmime sondazhi në monumentin e Alinurës.
- II. Periudha kohore e kryerjes së punimeve brenda gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2015.
- III. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR  
MIRELA KUMBARO FURXHI  
MINISTËR



SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO



Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)

Website: [www.asha.gov.al](http://www.asha.gov.al)